



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

[Tel/Fax: +355 4 2380 300/315](tel:+35542380300315)
[E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K1/S10-5 Prot.
Nr. Dok. 202503206/5

Tiranë 17.11.2025

Lënda: Rekomandim për marrjen e masave në përmbushje të kompetencave që u njeh legjislacioni organeve të pushtetit vendor lidhur me krijimin dhe gëzimin e lehtësirave në transport për të moshuarit.

Drejtuar: **BASHKISË SARANDË**
KËSHILLIT BASHKIAK SARANDË

Të nderuar,

Siç jeni në dijeni nga komunikimet e mëparshme institucionale, pranë institucionit të Avokatit të Popullit kanë paraqitur ankesat e tyre qytetaret S. S. e moshuar (65 vjeç), dhe F. P., e moshuar (69 vjeç), pensioniste, banore në qytetin e Sarandës, ku objekt i ankesës është pamundësia financiare e pensionistëve për të përballuar shpenzimet e transportit publik në Sarandë, si kategori me të ardhura të ulëta të pamjaftueshme për të përballuar nevojat bazë të jetesës. Ato shprehen se çimimi i biletave është rritur së fundmi dhe të ardhurat e tyre janë të pamjaftueshme për të përballuar edhe shpenzimet e transportit, të cilin e konsiderojnë shumë të rëndësishëm për të lehtësuar lëvizjen për nevoja shëndetësore, shërbime publike dhe sociale.

Sa më sipër, ankueset kanë kërkuar ndërhyrjen e institucionit të Avokatit të Popullit për shqyrtimin dhe verifikimin e kësaj çështjeje, me qëllim të mbrojtjes sa më efektive të të drejtave dhe interesave të ligjshme të kësaj kategorie në nevojë.

Në ushtrim të kompetencave kushtetuese e ligjore, Avokati i Popullit, pasi është njohur me problematikën e sipërcituar, vendosi marrjen në shqyrtim të saj dhe nisjen e hetimit administrativ, referuar përcaktimeve të ligjit nr. 8485, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” të ndryshuar¹.

Në kuadër të hetimit administrativ, të orientuar për gjetjen e një zgjidhjeje të drejtë e të qëndrueshme të rastit, Avokati i Popullit, në zbatim të detyrimit kushtetues e ligjor², i ka kërkuar Bashkisë Sarandë, informacion të plotë dhe shpjegime³ lidhur me transportin publik qytetas dhe ndërqytetas, në qytetin e Sarandës, kategoritë që përfitojnë lehtësira në transport sipas legjislacionit në fuqi, përmbushjen e këtij detyrimi nga operatorët që ofrojnë këtë shërbim, dhe çdo informacion në lidhje me mundësitë e Bashkisë Sarandë për ndihmën që mund të jepni dhe masat që mund të ndërmerreni për adresimin e problematikës së ngritur në ankesë.

Nga informacioni i përcjellë nga **Bashkia Sarandë**⁴ u informuam sa më poshtë:

Në bazë të ligjeve nr.7889/94, të ndryshuar, nr 7663/93, dhe nr.8626/00, të ndryshuar, në të cilat përcaktohet:

a) Për transportin qytetës.

- "invalidët e punës, invalidët e luftës, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët nga organizatat përkatëse janë të pajisur me dëshmi, kanë të drejtë të udhëtojnë falas, si dhe për zbatimin e ligjeve nr.8098/96, nr.8153/96, të dryshuar:

- "të verbrit e shoqëruesit e tyre dhe jetimët që nuk janë në marrëdhënie pune, udhëtojnë falas".

b) Për transportin rrethqytetës dhe ndërqytetës:

-"invalidët e punës, invalidët e luftës, invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët nga organizatat përkatëse janë të pajisur me dëshmi, kanë të drejtë të udhëtojnë

¹ Neni 13, paragrafi i parë: “Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike”.

² Neni 63, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet: “Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”, si dhe neni 19 pika b, Ligji Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet: “Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin”.

³ Shkresa nr. K1/S10-2 prot., dt. 12.08.2025 dhe shkresa nr. K1/F16-2 Prot. dt.12.08.2025 të Avokatit të Popullit.

⁴ Shkresa nr. K1/S10-4 Prot., dt. 21.08.2025 dhe shkresa nr. K1/F16-4, dt. 21.08.2025 “Kthim përgjigje” të Bashkisë Sarandë.

me 50% të vlerës së biletës, si dhe për zbatimin e ligjeve nr. 8098/96. nr. 8153/96. të ndryshuar:

-"të verbrit e shoqëruesit e tyre dhe jetimët që nuk janë në marrëdhënie pune, udhëtojnë falas";

nuk përcaktohet për të drejtën e pensionistëve për udhëtim falas.

Së dyti, pensionistët të cilët shprehin ankesë për pamundësi financiare për të përballuar shpenzimet janë të lutur ti drejtohen Drejtorisë së Kujdesit Social për aplikim për ndihmë ekonomike si familje në nevojë.

Konsiderata të Avokatit të Popullit.

Mbrojtja dhe përkujdesja ndaj të moshuarve në Shqipëri mbështetet mbi një kuadër të konsoliduar ligjor dhe politikash publike, të ndërtuar në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Si shtet anëtar i Këshillit të Evropës, Kombeve të Bashkuara dhe Organizatës Ndërkombëtare të Punës, Shqipëria ka ratifikuar një sërë instrumentesh detyruese që garantojnë respektimin e dinjitetit dhe të drejtave të të moshuarve. Në këtë kontekst, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (1950) siguron mbrojtjen nga trajtimet çnjerëzore apo degradues, Karta Sociale Evropiane (e rishikuar) (1996), e ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960/2002, përcakton detyrimin për të siguruar strehim, ndihmë dhe shërbime të përshtatshme për personat e moshuar dhe kërkon nga shtetet anëtare të mbrojnë të moshuarit nga izolimi shoqëror, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2006), e ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 116/2012, parasheh trajtim të barabartë dhe qasje në shërbime për të moshuarit me aftësi të kufizuara, duke theksuar përgjegjësinë shtetërore për të siguruar mbrojtje sociale dhe ekonomike të përshtatur me nevojat individuale, ndërsa Rekomandimi nr. 202 i Organizatës Ndërkombëtare të Punës thekson detyrimin e shtetit për të siguruar akses universal në kujdes afatgjatë për personat që përballen me varësi funksionale, përfshirë të moshuarit, si pjesë e standardeve minimale të sigurisë sociale. Këto angazhime ndërkombëtare ndërthuren me parimin e mosdiskriminimit, respektimin e dinjitetit dhe qasjen gjithëpërfshirëse, të cilat janë gjithashtu të reflektuara në Agjendën 2030 të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm⁵, veçanërisht në objektivat që kanë të bëjnë me çrrënjosjen e varfërisë, shëndet të mirë, barazi gjinore, rritje ekonomike dhe punë të denjë, reduktim të

⁵ objektivat 1, 3 dhe 10 përfshijnë masat për mbrojtjen sociale dhe reduktimin e pabarazive, me një theks të veçantë për grupet vulnerabël si të moshuarit.

pabarazive, qytete të qëndrueshme⁶ dhe institucione efektive dhe të përgjegjshme. Në nivel kombëtar, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacioni ynë i brendshëm njohin dhe mbrojnë të drejtat e personave të moshuar, duke përcaktuar detyrimet e shtetit për kujdesin ndaj kësaj shtrese dhe duke rregulluar ofrimin e shërbimeve sociale e shëndetësore për ta. Kushtetuta e Shqipërisë (1998), në Preambulën e saj, si dhe në Kapitullin IV mbi Liritë Ekonomike, Sociale e Kulturore, sanksionon parimet e barazisë dhe dinjitetit për të gjithë qytetarët, pa dallim moshe. Neni 59, germa (e) e Kushtetutës përcakton se ndër objektivat sociale kryesorë të shtetit është “përkujdesja dhe ndihma për të moshuarit, jetimët dhe invalidët”. Edhe pse lidhur me objektivat sociale, neni 59 përcakton se: *Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon plotësimin e tyre*, ato udhëheqin politikë-bërjen dhe procesin legjislativ, duke i ngarkuar organet publike me përgjegjësinë për mbrojtjen sociale të personave të moshuar. Gjithashtu, ligji themeltar i vendit tonë, përcakton Institucionin e Avokatit të Popullit (neni 60) si garant i mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve, ku përfshihen edhe personat e moshuar, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme të organeve publike. Kështu, Kushtetuta krijon bazën për një qasje shumëdimensionale ndaj të drejtave të të moshuarve, duke i vendosur ato në kuadrin e përgjithshëm të të drejtave të njeriut dhe objektivave sociale të shtetit.

Plani Kombëtar i Moshimit 2020-2024 në Shqipëri, parasheh se problemi më kritik i moshës së tretë është varfëria ekonomike, e shkaktuar nga mungesa ose pamjaftueshmëria e të ardhurave. Në vlerësim të peshës që zënë shpenzimet mesatare mujore për grupet kryesore të konsumit, sipas Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (2023)⁷ për Njësi Ekonomike Familjare (NJEJF)⁸, tregohet qartasi

⁶Objektivi 1: Fundi i varfërisë në të gjitha format e saj kudo – për të gjithë burrat dhe gratë.

Objektivi 2: T'i jepet fund urisë, të arrihet siguria ushqimore dhe të ushqyerit e përmirësuar dhe të promovohet bujqësia e qëndrueshme duke përfshirë edhe për të moshuarit.

Objektivi 3: Sigurimi i një jete të shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë në të gjitha moshat nëpërmjet mbulimit shëndetësor universal, duke përfshirë mbrojtjen nga rreziku financiar.

Objektivi 16: Promovimi i shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.

⁷ <https://www.instat.gov.al/sq/temat/kushtet-sociale/anketa-e-te-ardhurave-dhe-nivelit-te-jeteses-aan/publikimet/2024/matja-e-te-ardhurave-dhe-nivelit-te-jeteses-ne-shqiperi-2023/>; Publikuar në Dhjetor 2024, publikimi i Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2024 nuk është ende.

⁸ Në vitin 2023, shpenzimet mesatare mujore për konsum për një Njësi Ekonomike Familjare, e përbërë mesatarisht nga 3,7 persona, vlerësohen me 91.675 lekë. Ky tregues është 3,7 % më i lartë se në vitin 2022. <https://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-buxhetit-t%C3%AB-nj%C3%ABsive-ekonomike-familjare/publikimet/2024/anketa-e-buxhetit-t%C3%AB-nj%C3%ABsive-ekonomike-familjare-2023/>

se pensionistët përballen me sfida të mëdha në menaxhimin e financave personale⁹. Këto kushte i vendosin ata në vështirësi për të ruajtur një standard jetese të përshtatshëm.

Për këtë arsye, në kontekstin e shqetësimeve të vazhdueshme mbi mirëqenien e pensionistëve, të cilat janë adresuar në mënyrë të vazhdueshme nga institucioni i Avokatit të Popullit, është thelbësore që politikat publike të adoptojnë një qasje më të gjerë dhe gjithëpërfshirëse për të adresuar në mënyrë efektive nevojat dhe pritshmëritë e kësaj kategorie qytetarësh. Për të garantuar një standard jetese të qëndrueshëm dhe dinjitoz për ta, është thelbësore që institucionet përgjegjëse të ndërmarrin veprime konkrete dhe të mirëstrukturuara, duke e trajtuar këtë çështje si një prioritet social dhe ekonomik.

Avokati i Popullit si institucion i pavarur, i parashikuar shprehimisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, shërben si garanci kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, në përmbushje të misionit kushtetues, si garant i mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe nxitës i standardeve më të larta të këtyre të drejtave, i kushton një vëmendje të posaçme dhe ndjek e trajton me prioritet mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të grupeve në nevojë.

Sipas legjislacionit në fuqi¹⁰, transporti rrugor i udhëtarëve brenda vendit në formën e shërbimit të linjave të rregullta, ndahet në transport qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas. Transporti qytetas dhe ai rrethqytetas është në kompetencat e pushtetit vendor, ndërsa transporti ndërqytetas rregullohet nga ministri përgjegjës për veprimtarinë e transportit. Kjo ndarje e kompetencave sipas llojeve të transportit, ngarkon me përgjegjësi në mënyrë të veçantë pushtetin qendror, por njëkohësisht dhe atë vendor¹¹. Ligjvënësi ka vendosur mekanizmat ligjorë dhe mjetet proceduriale në dispozicion të bashkive/organeve të pushtetit vendor, për të mundësuar që ato të vijnë në ndihmë të shtresave në nevojë.

Ligji nr.8309/1998 “*Për transportet rrugore*”, i ndryshuar, neni 14, i jep kompetencë Këshillit Bashkiak që brenda juridiksionit të tij, të përcaktojë linjat, të

⁹<https://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-t%C3%AB-ardhurave-dhe-nivelit-t%C3%AB-jetes%C3%ABs-aani/publikimet/2024/matja-e-t%C3%AB-ardhurave-dhe-nivelit-t%C3%AB-jetes%C3%ABs-n%C3%AB-shqip%C3%ABri-2023/>

¹⁰ Ligji nr. 8098 “Për statusin e të verbërit”, Ligji nr. 7889 “Për statusin e invalidit të punës”, Ligji nr. 8626 “Për statutin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, Neni 85 i Ligjit nr. 8308 (18.03.1998) “Për transportet rrugore”, VKM nr.85, datë 08.02.2017 “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”.

¹¹ Ligji nr. 8308/1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar.

organizojë, financojë dhe vendosë për këtë lloj transporti, duke u mbështetur në nevojat e popullsisë për transportin qytetas. Më tej, VKM nr. 85, datë 08.02.2017 “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti ruugor”, pika 7, përcakton për udhëtarët, që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta, çmimi i biletave për transportin qytetas dhe rrethqytetas caktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për këtë qëllim, me vendim të këshillit të njësive të vetëqeverisjes vendore. Për shërbimin ndërqytetas të transportit rrugor të udhëtarëve, rregullat e posaçme, kriteret dhe procedurat për rimbursimin e shoqërive të transportit rrugor ndërqytetas për personat që përfitojnë lehtësi, sipas akteve ligjore dhe nënligjore të veçanta, caktohen me udhëzim të përbashkët të ministrave përgjegjës për financat, për transportin rrugor, për mbrojtjen sociale dhe për arsimin.

Gjithashtu, Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar¹² mundëson ushtrimin e autoritetit në interes publik vendor¹³. Në rastin konkret, neni 23, pika 6, përcakton përgjegjësinë e bashkive në territorin e juridiksionit të tyre, në fushën e transportit publik. Neni 32, pika 1, ngarkon me përgjegjësi njësitë e vetëqeverisjes vendore, të ofrojnë shërbimet publike, duke përdorur instrumenta të përshtatshëm për të siguruar aksesin, cilësinë, sasinë, dhe koston e përbalueshme nga të gjithë dhe pika 2 e këtij neni, cilëson se: mënyrat dhe kushtet për ushtrimin e shërbimeve publike, kur nuk janë të përcaktuara në ligj, përcaktohen vetë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Sa më sipër, Bashkia si institucioni në nivel lokal me afër qytetarëve mbështetur në mekanizmat ligjorë, duhet të sigurojë që mekanizmat financiarë të saj¹⁴ të sigurojnë që marrja e shërbimeve publike të mos i mohohet asnjë qytetari, pavarësisht rrethanave të veçanta. Është në misionin e organeve të qeverisjes vendore e kryesisht të bashkive, që të sigurojnë qeverisje të efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve¹⁵ sidomos ndaj familjeve/ individëve në nevojë.

¹² Ndryshuar me ligjin nr.38/2019.

¹³ Neni 8, Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor: 1. Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore mund të ndërmarrin nisma me interes publik vendor në territorin e juridiksionit të tyre për çdo çështje që nuk u ndalohet me ligj ose që nuk i është dhënë ekskluzivisht me ligj një organi tjetër shtetëror. 2. Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore ushtrojnë kompetencat e tyre nëpërmjet vendimeve, urdhërave dhe urdhrave.

¹⁴ Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 34, 35, 36, 37, 38, 39.

¹⁵ Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 3 përcakton: “Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

- a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;
- b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;
- c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;
- d) realizimit të shërbimeve në formë të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;
- dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithë-përfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
- e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative”.

Nga ana tjetër, ndihma ekonomike është një mekanizëm i rëndësishëm i mbrojtjes sociale për familjet në nevojë, por ajo nuk mund të përdoret si zëvendësues për përgjegjësitë e bashkisë në sigurimin e aksesit të barabartë në shërbime publike thelbësore, përfshirë lëvizshmërinë urbane të personave të moshuar. Ndihma ekonomike është masë individuale, e kushtëzuar dhe e përkohshme; ndërsa rregullimi i tarifave, miratimi i lehtësive dhe subvencionimi i transportit janë masa të politikës publike, të cilat bashkia i ushtron përmes vendimmarrjes së Këshillit Bashkiak dhe buxhetimit vendor. Për rrjedhojë, kur ka alternativa rregullatore ose financiare në kompetencat e njësive të vetëqeverisjes vendore dhe organeve pëërgjese vendore (p.sh. tarifa të reduktuara/ abone të posaçme për të moshuar, subvencionim i biletës, skema kompensimi për operatorët), referimi te ndihma ekonomike nga ana e Bashkisë Sarandë, është i gabuar për arsyet e sipërcituara.

Sa më sipër, për të kontribuar në përmirësimin e qasjes, institucionet e pushtetit vendor si institucionet përgjegjëse, duhet të garantojnë standardet më të larta për qeverisje në nivel sa më afër qytetarëve bazuar në parimin e subsidiaritetit. Organet e qeverisjes vendore, si përkundrejt qytetarëve, ashtu edhe përkundrejt adresimit të situatës në tërësi, duhet të garantojnë standardin e nevojshëm për qeverisje, garanci social-ekonomike për grupet në nevojë dhe standardin e nevojshëm të garantimit të të drejtave dhe, aq më tepër, nevojave thelbësore të qytetarëve.

Institucioni i Avokatit të Popullit monitoron me shumë vëmendje masat e marra nga autoritetet, për kategoritë më të rrezikuara, me qëllim garantimin e jetesës normale dhe dinjitoze për shtresat në nevojë.

Në këtë drejtim, Avokati i Popullit vlerëson të sjellë në vëmendjen tuaj se, Këshilli Bashkiak i Bashkisë Tiranë, ka miratuar Vendimin Nr. 125, datë 19.11.2024, i cili përcakton tarifat e transportit publik qytetas dhe rregullat për subvencionimin dhe kompensimin e tyre. Vendimi përfshin mekanizmat për subvencionimin e tarifave për kategori të caktuara, përfshirë pensionistët dhe studentët, si dhe përcaktimin e standardeve për sistemet elektronike të biletimit dhe monitorimit. Ky vendim shërben si një praktikë pozitive që reflekton një qasje të mirëorganizuar dhe të ndjeshme ndaj nevojave të grupeve të ndryshme shoqërore, duke demonstruar angazhimin e institucioneve vendore për të promovuar një sistem transporti publik gjithëpërfshirës dhe të aksesueshëm, duke garantuar lehtësi për pensionistët dhe përfitues të tjerë sipas kategorive në nevojë, të parashikuara nga ligji.

Ky model jo vetëm që përmirëson cilësinë e jetesës për banorët e Tiranës, por krijon një precedent pozitiv që duhet të ndiqet edhe nga bashkitë e tjera në Shqipëri, duke synuar zhvillimin e një infrastrukture moderne dhe të barabartë për të gjithë qytetarët. Kjo praktikë tregon se një administratë vendore mund të ndërtojë politika të balancuara dhe sociale, duke kontribuar jo vetëm në përmirësimin e transportit publik, por edhe në rritjen e mirëqenies së grupeve vulnerabël. Për këtë arsye, ajo mund të shërbejë si një shembull frymëzues për institucionet e tjera në vend dhe më gjerë.

Mbështetja për sigurimin e standardit më të lartë të të drejtave të njeriut, së bashku me mbrojtjen e anëtarëve më të prekshëm të komuniteteve tona nga një kërcënim ekzistencial, është qëllim legjitim. Një qasje e bazuar në të drejtat e njeriut, do të thotë që standardet dhe parimet e të drejtave të njeriut të jenë në thelbin e planifikimit dhe politikave shtetërore/vendore. Në këtë kuptim, përgjigja e institucioneve vendore përgjegjëse për të adresuar problematikat që hasin qytetarët në nevojë, duhet të jetë urgjente, dhe e koordinuar dhe në mbështetje të sa më shumë kategorive në nevojë. Ofrimi i shërbimeve të përballueshme për të kapërcyer sa më denjësisht situatat e vështira më të cilat përballen këto kategori qytetarësh, kërkojnë një vlerësim objektiv dhe të menjëhershëm si dhe garantim të shërbimeve bazë sociale.

Nga ana tjetër, mirëqeverisja, e cila afirmohet në mënyrë të veçantë nga Karta e të Drejtave Themelore e BE¹⁶, duhet të konsiderohet si një koncept prioritar në veprimtarinë e përditshme të organeve publike, e vënë në qendër të punës së Avokatit të Popullit edhe pas rezolutës së Kuvendit të RSH për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit për vitin 2023¹⁷, në të cilën Avokatit të Popullit i kërkohet të rrisë shqyrtimin e këtyre rasteve. Rritja e standardit të shërbimeve publike të ofruara nga organet e administratës në çdo nivel është në qendër të politikave dhe angazhimeve të shtetit shqiptar në kuadër të procesit të integritetit në Bashkimin Europian dhe përafrimit të legjislacionit tonë me Acquis Communautaire. Një iniciativë që tregon angazhim në këtë drejtim është Dokumenti i politikave të standardeve të shërbimeve në Shqipëri, i cili shqyrton sfidat që hasen në përkufizimin e standardeve të shërbimeve publike, si dhe paraqet kornizën e përgjithshme dhe zgjidhjet praktike të politikave për të nxitur zhvillimin e standardeve të shërbimeve që u ofrohen qytetarëve¹⁸.

Për sa më sipër, me qëllim garantimin e respektimit të të drejtave të personave të moshuar, me të ardhura të pamjaftueshme, bazuar në:

¹⁶ Neni 41 i Kartës së të Drejtave Themelore të EU https://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text_en.pdf

¹⁷ <https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/c3a6de63-882e-469e-bf1d-85b813a79595>

¹⁸ Dokument politikash për Standardet e Shërbimeve Publike në Shqipëri
<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/532>

- Nenin 1, të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, ku thuhet shprehimisht se: *“Të gjitha qëniet njerëzore lindin të lira e të barabarta nga pikëpamja e dinjitetit dhe e të drejtave”*;
- Pikën 3, të nenit 63, të Kushtetutës, ku thuhet shprehimisht se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*;
- Nenin 21/b, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit kryen këto veprime: paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave të njeriut...”*.

REKOMANDOJMË:

- *Ushtrimin e plotë dhe efektiv të kompetencave që u njeh legjislacioni organeve të pushtetit vendor, me qëllim sigurimin e mbështetjes financiare për të mundësuar lehtësira në transport për të moshuarit, në përputhje me parashikimet ligjore, me një qasje të mirëorganizuar dhe të përgjegjshme, duke u fokusuar në planifikimin dhe implementimin e masave që mbështesin këtë kategori në nevojë dhe përmirësojnë aksesin e tyre në shërbime publike;*
- *Marrjen e masave për të kryer rishikimin periodik të nevojave dhe kostove të lidhura me transportin për kategoritë në nevojë, për të siguruar që masat janë efektive, të zbatueshme dhe të qendrueshme;*

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, plotësuar me Ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me Ligjin nr.9398 datë 12.05.2005, ku përcaktohet se: *“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”*, lutemi, pas shqyrtimit, të na vini në dijeni për qëndrimin ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R E

Vilma SHURDHA

DV